

03

PK. SH.A.
 Posta e Kosovës SH.A.
 Post of Kosovo J.S.C.
 Pošta Kosova D.D.
 Nr./No./Br. 01-78/23
 Data/Date/Datum 17-01-2023
POSTAL LINE - POSTAL LINE



KONTRATË PËR KRYERJEN E SHËRBIMEVE POSTARE

(Shpërndarja e Faturave të Tatimit në Pronë)

E lidhur ndërmjet:

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN	
02 Nr. / Br	<u>46/23</u>
Nr. i fq. / Br. st	<u>-06-</u>
Data: / Datum	<u>17.01.2023</u>
VUSHTRRI - VUČITRN	

KRYESI I SHËRBIMEVE:

Posta e Kosovës SH.A. Adresa; Rr. 28 Nëntori, nr. 4, 10,000, Prishtinë, Republika e Kosovës. Me numër Unik Identifikues 811285205. E përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor znj. **Nora Raci** **Kryeshefe Ekzekutive**, PK SH.A., në tekstin e mëtejmë : Kryesi i Shërbimeve, dhe

POROSITËSI I SHËRBIMEVE:

Komuna e Vushtrrisë, Adresa sheshi "Ahmet Krasniqi" nr.10 - Vushtrri, e përfaqësuar nga Përfaqësuesi ligjor z. **Ferit Idrizi Kryetar i Komunës**, në tekstin e mëposhtëm : Porositësi i Shërbimeve.

OBJEKTI I KONTRATËS:

Është printimi, zarfimi (*me sigurimin e letrës dhe të zarfeve*), si edhe **shpërndarjen e dërgesave postare** (*faturave mbi tatimin në pronë të obliguesve tatimorë*), në adresat e destinimit.

AFATI KOHOR:

Kontrata për Kryerjen e Shërbimeve fillon prej **01/01/2023**, për një periudhe kohore prej një (1) viti, përkatesisht deri me datën **31/12/2023**, me mundësi vazhdimi edhe për një (1) vit, dhe duhet të jetë e nënshkruar nga të dy palët, jo më larg se data **31/12/2022**. Palët që nënshkruajnë, me marrëveshje të shkruar, vendosin për shërbimet e kërkua/orfuara gjatë vitit **2023**.

Në bazë të kësaj kontrate, kryerësi i shërbimeve dhe porositësi i shërbimeve bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Përkufizime Në këtë Kontratë për kryerjen e shërbimeve, përvèç kur konteksti e kérkon ndryshe, termat e përdorur kanë kuptimet e dhëna më poshtë:

PK SH.A: do të thotë Posta e Kosovës SH.A e cila do të bëj shpërndarjen e dërgesave postare (Faturave të Tatimit në Pronë) në adresat e destinimit;

KONTRATË: do të thotë kjo marrëveshje për kryerjen e shërbimit postar dhe me ndryshimet dhe plotësimet eventuale sipas nenit 4.2;

KRYERËSI I SHËRBIMEVE: do të thotë: Posta e Kosovës SH.A.

IT: do të thotë Departamenti (PK -Sh.a.) i cili kryen printimin e faturave, zarfimin e tyre;

POROSITËSI I SHËRBIMEVE: do të thotë: Komuna përkatëse.

AFAT: ka kuptimin e kohëzgjatjes së kësaj Kontrate.

TARIFA POSTARE: ka kuptimin e Listës së Çmimeve të Shërbimeve Postare sipas ofertës;

OBJEKTE POSTARE: ka kuptimin e dërgesave që nënkuption të gjitha shërbimet që kryen kryerësi i shërbimeve;

PERSONI KONTAKTUËS: ka kuptimin e personit, me të cilin bëhen kontaktet në lidhje me zbatimin e kësaj kontrate;

PRINTIMI I FATURAVE: nënkuption printimi i faturave të obliguesve tatimore në bazë të shënimive të marra nga baza e të dhënave nga MEF-i;

ZARFIMI: nënkuption futjen e faturave në zarfe dhe përgatitja për shpërndarje.

Neni 2 **Detyrimet e Palëve**

2.1. Kryerësi i Shërbimeve, do të bëjë Printimin, Zarfimin (dhe sigurimin e letrës dhe të zarfeve) dhe Shpërndarjen e dërgesave postare (faturave mbi tatimin në pronë të obliguesve tatimor), në adresat e destinimit, sipas ofertës së bashkangjitur në fund të faqes.

2.2. Kryesi i shërbimeve, detyrohet të bëjë pranimin e shënimive nga baza e të dhënave të porositësit të shërbimeve dhe të njëjtat shënime do të futen në faturat përkatëse, me të cilat bëhet faturimi i tatimit, në pronë i detyrimeve tatimore, mandej do të bëhet printimi i faturave në fjalë, zarfimi dhe pastaj shpërndarja e tyre deri te adresa e tatimpaguesit.

Në këtë mënyre faturat e gatshme të përgatitura për shpërndarje nga kryesi i shërbimeve (TI) kalojnë tek Drejtoria Operative PK Sh.A. sipas Regjoneve për shpërndarje të tyre në adresat e destinimit.

2.3. Kryesi i shërbimit, për shërbimet e kryera, përgatit faturat për pagesë për Komunën e Lartcekur. Pagesa e këtyre faturave, duhet të bëhet në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga përfundimi i shërbimit .

2.4. Faturat e përgatitura nga kryesi i shërbimit, do t'i dorëzohen Komunës në fjalë – si Porositës i Shërbimit .

2.5. Kryerësi i shërbimeve, duhet të njoftojë porositësin e shërbimeve, mbi shpërndarjen e faturave në fjalë (numrat dhe datat për secilën komunë) dhe për faturat e humbura gjatë printimit, në rast se ndodh kjo.

2.6. Kryesi i shërbimit, duhet të përfundojë printimin, zarfimin, shërbimet përcjellëse postare dhe shpërndarjen e të gjitha faturave tatimore për vitin 2023, në afatin e paraparë ligjor. Në rast të kërkesës, për shërbim shtesë ose ndryshim shërbimi gjatë vittit 2023, detajet përkufizohen në një shkresë të veçantë me shkrim, me miratimin e palëve, si aneks i kësaj kontrate.

2.7. Porositësi i shërbimit, detyrohet që kryesin e shërbimit (PK Sh.A.)ta furnizoj me të gjitha shënimet bazë të të gjithë obliguesve tatimorë, për të cilat duhet të përgatiten faturat për tatim në pronë dhe që pas përgatitjes, do të shpërndahen nga kryesi i shërbimeve.

2.8. Kryesi i Shërbimeve PK SH.A. zotohet se printim, zarfimi dhe shpërndarja do të bëhet në afatet e parapara me këtë Kontratë.

2.9. Kryesi i Shërbimeve PK SH.A. nuk mban përgjegjësi në rast se porositësi i shërbimeve nuk i saktëson adresat, për faturat e tatimit në pronë, ato me adresa gjysmake apo

faturat fare pa adresa në këto raste për faturat e shtypura pagesa duhet të kryhet nga porositësi i shërbimeve njësoj sikur edhe për faturat e shpërndara.

Neni 3 Kushtet e Pagesës

3.1. Kryesi i shërbimeve për shërbimet e bëra nga neni paraprak i kësaj kontrate përmes faturës ja faturon shërbimet e bëra porositësit të shërbimit. Faturat do të tarifohen në emër të Komunës përkatëse dhe ato i dorëzohen direkt atyre.

3.2 Kryesi i Shërbimit për shërbimet e bëra; printim, zarfim, dhe shpërndarje të këtyre dërgesave i faturon porositësit të shërbimit me çmimin prej si me poshtë:

Çmimi për dërgesë (FATUR TË TATIMI NË PRONË) me peshë deri 50 gr.,

Letër dërgesat postare të thjeshta(THJ) trafiku vendor.

*OFERTA PËRFOSHINË : Letrën A4 (*shtypjen bardh e zi*); Zarfin C5 deri në 5 fletë dhe C4 për dërgesë mbi 5 fletë; Thyerjen dhe zarfimin për çdo dërgesë; Shpërndarjen e dërgesave sipas shërbimit të përzgjedhur: Letër dërgese e thjeshte(THJ).

Për dërgesa deri në dy(2) faqe, çmimi sipas Tabelës 1

Tabela 1 : Letër dërgesat postare të thjeshta(THJ) trafiku vendor

Çmimi për dërgesë (TATIMI NË PRONË) me peshë deri 50 gr. Deri në dy faqe Letër dërgesat postare të thjeshta(THJ) trafiku vendor	
Letra dhe shtypja – bardh e zi	0.033
Zarfi	0.071
Palosja	0.045
Shpërndarja e thjeshtë me peshë deri 50 gr.	0.50
Totali	0.649 €

Për dërgesa me tre(3) faqe e më shumë, sipas Tabelës 2

Tabela 2 : Letër dërgesat postare të thjeshta(THJ) trafiku vendor

Nr.	Përshkrimi i artikullit-lloji i shërbimit	Pesha gr	Shtypja A4 bardh /zi çmimi rritet për çdo faqe shtesë	Faqe	Zarfi C5 përdoret për dërgesa deri në 4 fleta ndërsa C4 për dërgesat me mbi 5 fletë	Thyerje dhe zarfim për një dërgesë	Total printimi sipas faqeve	Gjithsejtë	Shërbimi i dërgesës Thjeshtë THJ	Çmimi total për njësi (€)
1	Dërgesa e thjeshtë THJ (bardh e zi)	deri 50 gr.	0.028	3	0.07	0.045	0.084	0.20	0.50	0.700
2	Dërgesa e thjeshtë THJ (bardh e zi)	mbi 50-100	0.028	8	0.10	0.045	0.224	0.37	0.60	0.969
3	Dërgesa e thjeshtë THJ (bardh e zi)	mbi 100-250	0.028	45	0.10	0.045	1.260	1.41	0.80	2.205
4	Dërgesa e thjeshtë THJ (bardh e zi)	mbi 250-500	0.028	95	0.10	0.045	2.660	2.81	1.20	4.005
5	Dërgesa e thjeshtë THJ (bardh e zi)	mbi 500-1000	0.028	195	0.10	0.045	5.460	5.61	1.50	7.105
6	Dërgesa e thjeshtë THJ (bardh e zi)	mbi 1000-2000	0.028	395	0.10	0.045	11.060	11.21	2.50	13.705

Numri i përafërt i fletëve dhe zarfi

Tabela 3 :

Pesha gr	Numri i përafërt i fletëve dhe zarfi (13gr)
deri 50	Deri 7 copë + zarfi A5
51-100	Deri 19 copë + zarfi A4
101-250	Deri 51 copë + zarfi A4
251-500	Deri 106 copë + zarfi A4
500-1000	Deri 215 copë + zarfi A4
1000-2000	Mbi 215 copë (max deri 2kg.) A4

Të gjitha çmimet janë me TVSH

3.3 Në rastet ku gjatë afatit kontraktues, me ndonjë vendim institucional nga rregullatori apo operatori publik, ka ndryshim të tarifave të shërbimeve postare (shpërndarjes), konsumatori obligohet që të paguaj faturat sipas tarifave të ndryshuara.

3.4. Porositësi i shërbimit obligohet që pagesën për shërbimet e kryera të bëjë në llogarinë bankare të Postës së Kosovës SH.A. sipas faturës se dorëzuar, në afat prej 30 ditëve me shenjen për të hyrat e „Posta e Kosovës SH.A”.

Neni 4 Ndryshimi i Kontratës

4.1. Kjo kontratë, do të mbetet në fuqi dhe do të jetë e vlefshme në çdo rast transferimi ose kalimi.

4.2. Ndryshimet në ketë Kontrate, duhet të bëhen vetëm me shkrim, me nënshkrime të Përfaqësuesve të Autorizuar, ose pasardhësve të tyre, me autorizim të Titullarëve të Institucioneve respektive, për çdo rast.

4.3. Çdo çështje e pa trajtuar në këtë Kontratë, do të zgjidhet me pajtimin dhe shqyrtimin e palëve kontraktuese në përputhje me Ligjin „Mbi Shërbimet Postare”.

Neni 5 Përgjegjësité

5.1. Kryesi i Shërbimeve, është përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar në pajisjet për shkak të akteve ose mosveprimeve të tij, nga pakujdesia, keq shfrytëzimi ose keqpërdorimi prej personelit të tij, qoftë ky i prekshëm ose i paprekshëm, në secilin prej rasteve të lartpërmendura, të cilat ndodhin gjatë përmbushjes ose në lidhje me përmbushjen e kësaj Kontrate.

5.2 Çdo dërgesë postare që është objekt reklamacioni do të trajtohet sipas ligjeve dhe akteve nënligjore që janë në fuqi në kohen e paraqitjes së reklamacionit.

5.3. Kryesi i Shërbimeve. nuk mban përgjegjësi nëse këto janë të natyrës që përshkruhet në Nenin 6 (Forçë Madhore).

Neni 6 Forca Madhore

6.1. Nëse, në çdo kohë, gjatë afatit kohor, të përcaktuar në ketë Kontrate, përmbushja plotësish ose pjesërisht nga secila Palë, e çdo detyrimi sipas kësaj Kontrate, pengohet ose vonohet për shkak të luftës, luftës civile, armiqësisë, akteve të armikut publik, rebelimit, revolucionit, fuqisë ushtarake ose të usurpimit, shqetësimave civile, demonstratave ose kërcënimeve të menjëherëshme lidhur me gjithë sa më lart, sabotazhit, zjarrit, përmbytjes, shpërthimeve, pandemive, epidemive, kufizimeve për shkak të karantinës, shqetësimave në furnizime nga burime normalisht të besueshme (ku përfshihen por jo vetëm elektricitet, ujë, naftë dhe të ngjashme), greva, përjashtime, vendime qeveritare ose ndonjë ngjarje tjetër jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës në fjalë (këtu e më poshtë e përmendur si "ndodhia"), atëherë përmbushja e këtyre detyrimeve do të falet në masën që u pengua ose u vonua dhe pala e prekur ka marrë njoftim për këtë ndodhi, nga Pala tjetër brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e ndodhisë, duke pasur parasysh që ngjarja e çdo ndodhie, nuk justifikon asnë detyrim të secilës Palë për të kryer pagesa.

6.2. Asnjëra Palë, për shkak të ndodhisë, nuk ka të drejtë të zgjidhë këtë kontrate ose të ngrejë pretendime për dëme kundër palës tjetër, në lidhje me mos përmbushjen ose vonesën në përmbushje. Përmbushja e detyrimeve të cenuara, duhet të rifillojë sapo të jetë praktike pas përfundimit ose pushimit të ndodhisë në fjalë.

6.3. Nëse përmbushja tërësisht ose pjesërisht e ndonjë detyrimi sipas kësaj kontrate vonohet për shkak të ndonjë ndodhie të tillë, për një periudhë që tejkalon 3 (tre) muaj, Palët do të takohen dhe rishikojnë në mirëbesim dëshirueshmërinë dhe kushtet për zgjidhjen e Konratës.

Neni 7 Marrëveshja e Plotë

7.1. Palët bien dakord se marrëveshja dhe mirëkuptimi në mes tyre, përfundon prej datës efektive të kësaj kontrate, me kusht që, të gjitha shumat që përbëjnë detyrim ndaj secilës Palë, sipas marrëveshjes së mëparshme, mbeten ende detyrime dhe të pagueshme.

Neni 8 Zgjidhja e Konratës

8.1. Kontrata fillon efektet ligjore me nënshkrimin nga të dyja palët dhe përfundon deri 31/Dhjetor/2023, me mundësi vazhdimi edhe për një (1) vit.

8.2. Para përfundimit të afatit të Konratës, 60 (gjashtëdhjetë) ditë, palët duhet të shqyrtojnë mundësinë e vazhdimit të kontratës dhe bashkëpunimit, me kërkesën paraprake me shkrim për vazhdim dhe në rast nevoje ndryshim shërbimi të kërkuar nga ana e porositësit të shërbimit.

8.3. Zgjidhja e konratës është e mundur edhe nëse dispozitat ligjore mbi shërbimet postare e parashohin një mundësi të tillë.

Neni 9
Përfaqësuesit

Për Kryesin e Shërbimit - PK Sh. A, Personi Kontaktues do të jetë znj. Pranvera Hasani - Koordinatore e Shitjes PK Sh.A. emaili: pranvera.hasani@postakosoves.com, zyrtare përgjegjëse për përcjelljen, kujdesin dhe menaxhimin e zbatimi të kontratës, me nr. tel +383(0)44/300-221, apo nga **Shitja - PK Sh.A**, nr. tel; 038/534-478.

Për Porositësin e Shërbimit, Personi Kontaktues do të jetë z. Qemail Hasani Udhëheqës i Sketorit të Tatimit në Pronë Komuna Vushtrri , me numer kontaktues tel. +383(0)/45/361207 , dhe e-mail gemail.xh.hasani@rks-gov.net.

Neni 10
Ligji dhe Juridiksi

- 10.1. Në rast të çdo mosmarrëveshjeje, që lind për shkak ose në lidhje me përbushjen ose interpretimin e kësaj kontrate, Palët, bien dakord të takohen dhe të negociojnë në mirëbesim, për të arritur një zgjidhje miqësore, në mungesë të së cilës, vendimin për zgjidhje të mosmarrëveshjes, do ta marrë Gjykata kompetente e Prishtinës.
- 10.2. Në rast të ndonjë mosmarrëveshje lidhur me versionin, versioni në gjuhën Shqipe do të mbizotërojë.
- 10.3. Kjo Kontratë hartoitet dhe nënshkruhet në **3 (tre)** kopje origjinale, për të dy (2) Palët nga 1 (një) kopje origjinale, dhe një (1) kopje për Departamentin e Tatimit në Pronë.

**PËR DHE NË EMËR
TË KRYESIT TE SHERBIMEVE**



Kryeshefe Ekzekutive e PK, SH.A.

Datë: 17/01/2023

**PËR DHE NË EMËR
TË POROSITESIT TE SHERBIMEVE**

Ferit Idrizi
z. Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës Vushtrri



Datë: 11/01/2023